

AKT THEMELIMI

PER KRIJIMIN SI PERSON JURIDIK TE SHOQERISE "COOLAIR REFRIGERATION SOLUTIONS" SHPK

Sot me dt 11.12.2024

Ky akt themelimi u perpilua nga ortaku themelues, z. Anri Dhima i datelindjes 31.12.1987, lindur ne Fier, banues ne Tirane, i pajisur me karte identiteti nr. 034416283 (I71231045Q), si themelues i kesaj shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, ku ai eshte Ortak i Vetem, sot me daten 11.12.2024 vendosi te hartoje kete Akt – Themelimi, mbeshtetur ne parimet e meposhteme.

FORMIMI

Ortaku i Vetem formon nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin nr 9901 dt 14.4.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare", Ligjit nr 9723 date 3.5.2007 per QKR-ne si dhe ne perputhje me nenin 26 e vijues te Kodit Civil.

Shoqeria do te filloje te veproje si person juridik qe nga dita e rregjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregetar te Shoqerive Tregetare prane QKB-se, ndersa veprimtaria ekonomike fillon me rregjistrimin ne organet tatimore

Neni 1. EMRI I SHOQERISE

Emri i shoqerise tregtare do te jete "COOLAIR REFRIGERATION SOLUTIONS" shpk TIRANE.

Neni 2. SELIA E SHOQERISE

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresen: Tirane, Berxull, Berxull, Lagjia Berxull, Rruga "Egnatia" Nr.40, Zona Kadastrale Nr.1167. Nr pasuire 701/21, vol 8, Fq.112.

Asambleja e përgjithshme mund të vendosë të transferojë selinë e Shoqërisë në një vend tjetër, apo mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë kudo, brënda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 3. KOHEZGJATJA

Afati i veprimtarise se shoqerise do te jete i pakufizuar. Me vullnetin e Ortaku te Vetem, kjo shoqeri mund te mbyllet edhe para ketij afati, ne rastet kur kjo shoqeri humbet efektivitetin e saj ekonomik.


Neni 4. AFATI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Afati i veprimtarise se shoqerise do te jete i pakufizuar. Si dite fillestare do te merret data e regjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregtar te QKB-se Tirane.

Neni 5. OBJEKTI VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem:

- Studim, projektim, ndertim, montim, zbatim, tregtim dhe mirembajtje sistemesh e pajisjesh ftohese, ngrohese, aspiruese, dhoma frigoriferike, ftohese etj
- Import-eksport pajisjesh e pjese kembimi per sisteme ftohese, ngrohese, aspiruese etj.
- Import – Eksport gaz ftohes HIDROFLUOROCARBONE,
- Transport kombetare dhe nderkombetare mallrash etj



Ortaku i Vetem gezon te drejten te beje ndryshime ne objektin e veprimtarise se shoqerise sa here ai e ndien te nevojshme.

Neni 6. KAPITALI

Kapitali themltar shoqerise eshte 100.000 (njqind mije) lekë dhe zoterohet teresisht prej Ortakut te Vetem, ndare ne 100 kuota me vlere nominale 1,000 secila kuote. Shlyerja e kapitalit do te behet pas rregjistrimit ne QKB.

Neni 7. STRUKTURA JURIDIKE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Shoqeria ka keto organe drejtuese:

- a) Asambleja e ortakeve (Ortaku i vetem)
- b) Administratori.

Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet sipas parashikimeve te nenit 81 te ligjit 9901 dt 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqerite Tregtare".

Administrator i shoqerise eshte Z. Anri Dhima, per nje periudhe kohe deri ne 5 vite me te drejte riperteritje.

DISPOZITE E FUNDIT

Ndryshimet ne kete AKT mund te behen vetem me shtese me shkrim dhe te miratuar nga Ortaku i Vetem. Pjese e pandare e ketij akti eshte Statuti i Shoqerise i cili nenshkruhet rregullisht nga themeluesi i shoqerise. Ky Akt Themelimi u hartua ne Tirane ne 4 kopje origjinale, i cili nenshkruhet rregullisht konform ligjes. Rregjistrimi ne QKB do te behet nga vet ortaku Z. Anri DHIMA

ORTAKU I VETEM

Anri DHIMA

